



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 27 mars, Zyra e Prokurorit të Specializuar thirri dëshmitarin e parë të saj për të dëshmuar në gjykimin e Pjetër Shalës.

Dëshmitari dëshmoi se babai i tij, i cili mbështeste Lidhjen Demokratike të Kosovës, pretendohet se ishte ndaluar dhe keqtrajtuar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri. Dëshmitari u mor në pyetje nga Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja. Gjykatësit e Trupit Gjykues i bënë gjithashtu pyetje dëshmitarit.

Dëshmitari i parë e përfundoi dëshminë e tij të martën, më 28 mars dhe dëshmitarja e dytë e thirrur nga Prokuroria filloi dhënien e dëshmisë së saj më të njëjtën ditë. Ajo dëshmoi për ndalimin dhe keqtrajtimin e pretenduar të bashkëshortit të saj në fabrikën e metalit në Kukës.

Gjatë seancës gjyqësore të 28 marsit, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër gojor me të cilin miratoi kërkesën e z. Shala për të marrë pjesë në gjykim përmes videolidhjes nga objekti i paraburgimit.

Dëshmitarja e dytë e përfundoi dëshminë e saj ditën e djeshme, 29 mars dhe dëshmitari i tretë e filloi dëshminë e tij më të njëjtën ditë. Dëshmitari i tretë dëshmoi për ndalimin dhe keqtrajtimin e pretenduar të babait të tij në fabrikën e metalit në Kukës.

Në seancën e sotme në gjykimin ndaj Shalës, dëshmitari i tretë e përfundoi dëshminë e tij ndërsa dëshmoi edhe dëshmitari i katërt i thirrur nga prokuroria.

Këtë javë, të katër dëshmitarët në çështjen gjyqësore *Shala* i dhanë dëshmitë e tyre nën masa mbrojtëse, përfshirë ndryshimin e zërit dhe pamjes.





Prokuroria ka bërë të ditur se në kuadër të paraqitjes së provave të saj synon të mbështetet në gjithsej 19 dëshmitarë, 14 prej të cilëve është parashikuar t'i japin dëshmitë e tyre në sallën e gjyqit.

Më 23 mars, Trupi Gjykes I njoftoi se do të lëshojë një urdhër për zhdëmtim në çështjen kundër Salih Mustafës më 6 prill. Ligji përcakton që nëse trupi gjykes e shpall të akuzuarin fajtor për një vepër penale, ai mund të lëshojë një urdhër ku specifikohet kompensimi i përshtatshëm për viktimat ose në lidhje me ta, bashkërisht ose individualisht. Trupi Gjykes do ta dorëzojë Urdhrin për zhdëmtim në seancë publike dhe në prani të z. Mustafa.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, deklaratat hyrëse të Prokurorisë, Mbrojtësit të Viktimave dhe Mbrojtjes janë caktuar të mbahen javën e ardhshme, në datat 3, 4 dhe 5 prill 2023. Paraqitja e provave nga Prokuroria është caktuar të fillojë më 11 prill 2023.

Ju lutemi përfaqësuesve të mediave ose pjesëtarëve të publikut që dëshirojnë të përcjellin deklaratat hyrëse nga galeria publike në Hagë të kenë parasysh se për të përcjellë seancën nevojitet regjistrim paraprak. Për shkak të interesit të lartë dhe hapësirës së kufizuar, mund të zbatohen kufizime. Të gjithë atyre që janë regjistruar paraprakisht do t'u jepet informacion më i detajuar brenda ditës së sotme. Njerëzit gjithashtu kanë mundësinë të ndjekin seancën në të tri gjuhët e gjykatës përmes transmetimit në faqen e internetit të DHSK-së.

Më 24 mars, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës u mbledhën në plenaren e tetë. Gjatë plenares, gjykatësit miratuan një ndryshim në Kodin e Etikës Gjyqësore, ku përcaktohet se politika kundër ngacmimeve e Dhomave të Specializuara të Kosovës të zbatohet edhe për gjykatësit. Kodi i Etikës Gjyqësore u miratua nga gjykatësit gjatë plenares së parë në mars 2017. Kodi i Etikës Gjyqësore ndalon çdo formë diskriminimi, ngacmimi, ngacmimin seksual, dhe shpërdorimin e pozitës zyrtare. Në plenare, Kryetarja gjithashtu u dha gjykatësve informacione të tjera të përditësuara për zhvillimet më të fundit në lidhje me çështje institucionale aktuale dhe ata dëgjuan paraqitjen që bëri Administratorja.





Në lajme të tjera përmendim se javën e kaluar ekipi i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim të DHSK-së zhvilloi një takim me studentë të drejtësisë dhe shoqërinë civile në Prishtinë, për të dhënë informacion të saktë rreth DHSK-së dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me proceset gjyqësore. Ekipi gjithashtu organizoi një tryezë të dytë të rumbullakët ku u dha informacion praktik për gazetarët që raportojnë në lidhje me gjykimet që po zhvillohen në gjykatë.

## Pyetjet e gazetarëve

